

VENDIM
Nr.109, datë 15.2.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE MINISTRIA E BRENDSHME DHE TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË RRUGORE SHKODËR, TË DISA OBJEKTEVE
E TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR.426, ME EMËRTIM
“SHTABI I BRIGADËS SË ARTILERISË”, ME VENDNDODHJE NË RRENC,
SHKODËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**
(Ndryshuar me VKM nr. 118, datë 13.2.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 31 165.2 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m², pjesë e pronës nr. 426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’i përdorur si qendër akomodimi të popullsisë së evakuuar, stacion magazinimi dhe për shpërndarje të rezervave për plotësimin e nevojave të komunitetit, në rastet e fatkeqësive natyrore në zonën e Shkodrës.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë Rrugore Shkodër, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 2 381.8 (dy mijë e treqind e tetëdhjetë e një pikë tetë) m², pjesë e pronës nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’i përdorur për zyra, për plotësimin e nevojave të administratës së Drejtorisë Rrugore Shkodër.

3. Prona nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të pronës të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

5. Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

6. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha